

URDHËR
Nr. 419, datë 14.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË NR. 169,
DATË 10.6.2020, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR
PARAQITJEN DHE TRAJTIMIN E SHPREHJEVE TË INTERESIT, SI DHE
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE PËR ANËTARË TË
BORDIT DISIPLINOR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 42, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 169, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon jo më vonë se 5 ditë nga mbarimi i afatit për dorëzimin e dokumentacionit dhe përfundon jo më vonë se 60 ditë nga data e nisjes.”.

2. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. Subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim administrativ pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 11 të këtij urdhri.”.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)